



**Partia Demokratike e Kosovës
(PDK)**

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Audituesit të pavarur

01 Janar 2014 - 31 Dhjetor 2014



Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9 - 17

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar Raportet Financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (tani e në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “PDK”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2014, Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë”, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne faqet 7-17.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2014, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174, Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion të kualifikuar

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit ne paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 2 Toka, Objektet dhe Pajisjet, të pasqyrave financiare të bashkëngjitura, Subjekti Politik ka deklaruar pasuri afatgjatë në vlerë 139,920.38 euro me 31 Dhjetor 2014 (166,821.47 euro; 31 Dhjetor 2013). Duke pasur parasysh evidencën e mangët që ka prezantuar SP dhe në mungesë të dokumentacionit mbështetës, ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde e ato alternative të auditimit, të përfitojmë një siguri të arsyeshme në lidhje me tërësinë, ekzistencën dhe saktësinë e vlerës 77,555.03 Euro me 31 Dhjetor 2014.

- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 5 “Detyrimet tjera afatshkurtra”, të pasqyrave financiare të bashkangjitura, Subjekti Politik ka deklaruar detyrimet tjera në vlerë 359,640.84 euro me 31 Dhjetor 2014; (306,514.07 euro me 31 Dhjetor 2013). Në mungese të konfirmimeve nga palët e treta, ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe ato alternative të auditimit, të përfitojmë një siguri të arsyeshme në lidhje me tërësinë, ekzistencën dhe saktësinë e vlerës 303,868.82 Euro më 31 Dhjetor 2014.
- Ashtu siç prezantohet në shënimin 6 “Donacionet në të holla”, Subjekti Politik ka pranuar donacione në të holla përmes arkës në shumë totale prej 2,780.00 euro gjatë vitit 2014 me çka ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 4 të ligjit Nr 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr 03/L-174 për financimin e partive politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr 04/L-058 i cili e lejon që pranimi i mjeteve të bëhet vetëm përmes llogarisë bankare.
- Ashtu siç prezantohet në shënimin 7 “Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime”, Subjekti Politik ka deklaruar kontribute në natyrë nga vëzhguesit në shumë totale prej 99,735.00 euro gjatë vitit 2014. Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që subjekti politik nuk dokumentacion mbështetës për kontributet e pranuar, marrëveshje, deklarata etj.
- Ashtu siç prezantohet në Shënim 8 “Shpenzimet”, Subjekti Politik ka deklaruar shpenzime në kategorinë “Pagat dhe Kompensimet” në vlerën prej 664,333.67 EUR, gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që ka mospërputhje në mes të pagave të deklaruara në Administratën Tatimore të Kosovës dhe pagave të prezantuara në pasqyra financiare në vlerë 12,609.08 EUR.

Theksim i çështjes

Pa e kualifikuar me tutje opinionin ton, ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për të mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare konform Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik ka kryer pagesa një marrësi të vetëm në vlerë mbi 5,000 € brenda një dite që është në kundërshtim me kërkesat ligjore të "Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit" me nr. 03/L-196 datës: 30 Shtator 2010, neni 25 Detyrimet shtesë të partive politike dhe kandidatëve të regjistruar.
- Subjekti Politik në blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedure të tenderimit e cila do të mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve

politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

- Gjatë auditimit tone ne kemi vërejtur qe te shpenzimet e reprezentacionit, ne disa raste SP nuk ka dokumentacion relevant mbështetës, përveç faturave, qe do munde te arsyetonin dhe mbështetnin shpenzimin e ndodhur.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj(parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo

për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Qerim Qerimi
Auditor Ligjor
5 Dhjetor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	2	139,920.38	166,821.47
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		139,920.38	166,821.47
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme			
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	671.05	19,735.81
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		671.05	19,735.81
Total pasuritë		140,591.43	186,557.28
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		(296,899.22)	371,417.06
Suficiti / (deficiti) i vitit		(193,399.56)	(668,316.28)
Total Ekuiteti		(490,298.78)	(296,899.22)
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera	2	139,920.38	166,821.47
Gjithsej detyrimet afatgjata		139,920.38	166,821.47
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	4	131,328.99	10,120.96
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	5	359,640.84	306,514.07
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		490,969.83	316,635.03
Gjithsej detyrimet		630,890.21	483,456.50
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		140,591.43	186,557.28

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2014	2013
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		1,099,374.10	1,000,109.13
Të hyrat nga anëtarësia			186.00
Donacionet dhe kontributet në të holla	6	3,280.00	8,661.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	7	99,735.00	0.00
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera	2	45,777.02	43,896.12
Të hyrat tjera			
Gjithsej të hyrat për vitin		1,148,431.12	1,052,852.25
Shpenzimet			
Pagat dhe kompensimet	8	664,333.67	570,403.59
Shpenzimet e transportit	8	63,612.73	23,905.72
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	8	140,263.01	60,329.74
Shpenzimet e fushatës	8	407,312.02	741,308.79
Blerja e mallrave	8	2,787.48	13,626.98
Shpenzimet e përgjithshme	8	123,459.43	135,917.07
Shpenzimet e ndryshme	8	39,797.34	175,676.64
Gjithsej shpenzimet për vitin		1,441,565.68	1,721,168.53
Suficiti / (deficiti) për vitin		(193,399.56)	(668,316.28)

1. Informata te përgjithshme

Partia Demokratike e Kosovës është parti popullore e themeluar mbi vlerat tradicionale, kombëtare, vlerat e luftës çlirimtare dhe vlerat universale të demokracisë qytetare. Partia Demokratike e Kosovës është themeluar në Kuvendin Themelues të mbajtur më datën 12.10.1999.

Emri zyrtar i partisë është Partia Demokratike e Kosovës. Shkurtesa zyrtare e Partisë Demokratike të Kosovës është PDK.

PDK synon zhvillimin e Kosovës si një vend i lirë dhe demokratik, i bazuar në sundimin e ligjit, në demokracinë kushtetuese dhe parlamentare, në shtet të fortë dhe funksional, me ekonomi të lirë të tregut, i cili garanton të drejtat themelore dhe liritë e qytetarëve, respekton vlerat kushtetuese, tradicionale, morale, historike dhe kombëtare, mbron dinjitetin njerëzor, familjen, pronën private dhe ndërmarrësinë

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës për vitin 2014 është : Z. Hashim Thaqi
Sekretari i përgjithshëm : Z. Bastri Musmurati

Pasqyrat financiare te Partisë Demokratike te Kosovës janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Subjekti Politik mirëmban llogari kryesore bankare ne bankën NLB.

Shënimi 2: Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka			////////////////////		0.00
Objektet					0.00
Veturat	102,702.21	4,679.00	24,250.41	21,476.24	61,654.56
Pajisjet e zyrës	56,942.71	0	19,401.24	11,388.54	26,152.93
Pajisjet e teknologjisë informative	56,415.70	5,996.00	15,376.80	12,482.24	34,552.66
Pajisjet tjera	10,509.47	8,200.90	720.14	430	17,560.23
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	226,570.09	18,875.90	59,748.59	45,777.02	139,920.38

Shënimi 3. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro
Paraja në bankë	156.78	17,541.18
Paraja në arkë	514.27	2,194.63
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	671.05	19,735.81

Shënimi 4. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro
Të pagueshme ndaj furnitorëve		
Llogarite e pagueshme te tjera	131,328.99	10,120.96
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	131,328.99	10,120.96

Shënimi 5. Detyrimet tjera afatshkurtra

	Me 31 Dhjetor 2014 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	46,549.77	7,821.80
Detyrimet për qira	9,722.25	4,164.75
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	0.00	93,150.00
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)	303,368.82	201,377.52
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	359,640.84	306,514.07

Shënimi 6. Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
Shpend Krasniqi	Junik	1009843361	30.01.2014	100.00		100.00
Astrit Thaçi	Kramovik - Rahovec	1002295411	17.02.2014	500.00		500.00
Muhamet Goçi	Junik	1009372748	25.02.2014	150.00		150.00
Sinan Ymeri	Shtërpçë		14.03.2014	500.00	500.00	0.00
Elvis Pista	Rahovec	1007865275	25.03.2014	250.00		250.00
Ibish Krasniqi	Junik	1009374300	28.03.2014	150.00		150.00
Kadri Shala	Junik	1009374511	30.04.2014	150.00		150.00
Avdyl Gjocaj	Gjocaj - Junik	1009811288	25.05.2014	100.00		100.00
Nevruz Krasniqi	Junik	1009816336	30.06.2014	150.00		150.00
Rrezarta Goçi	Junik	1500329471	30.07.2014	100.00		100.00
Fehmi Hoxha	Rahovec	1007987672	01.11.2014	80.00		80.00
Behar Rama	Rahovec	1002746138	01.11.2014	80.00		80.00
Lulzim Sylejmani	Pataçan I Ulët	1007860877	01.11.2014	80.00		80.00
Lulzim Hasku	Rahovec	1002401823	01.11.2014	80.00		80.00
Muhamet Behra	Krushë e Madhe	1003193213	01.11.2014	80.00		80.00

Partia Demokratike e Kosovës

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor, 2014

Fehim Fetoshi	Fortesë	1002634160	01.11.2014	80.00		80.00
Salih Sallteku	Malesi e Vogël	1006145350	01.11.2014	80.00		80.00
Idriz Vehapi	Zatriq	2006141547	01.11.2014	80.00		80.00
Rasim Fasliu	Celinë	1003190460	05.11.2014	40.00		40.00
Beatrisa Demiri	Rahovec	1002401947	05.11.2014	40.00		40.00
Astrit Thaçi	Kramovik - Rahovec	1002295411	05.11.2014	70.00		70.00
Qazim Qeska	Rahovec	1007984916	05.11.2014	40.00		40.00
Rexhep Oruqi	Rahovec	1030389022	05.11.2014	40.00		40.00
Elvedina Cana	Rahovec	1231515107	05.11.2014	40.00		40.00
Erlira Mullabazi	Rahovec	1176323279	05.11.2014	40.00		40.00
Lirim Berisha	Drenoc	1030382834	05.11.2014	40.00		40.00
Florida Krasniqi	Brestoc	1171961455	05.11.2014	40.00		40.00
Ejup Kabashi	Opterushë	1002291823	05.11.2014	40.00		40.00
Kadri Dellova	Krushë e Madhe	1005934288	05.11.2014	60.00		60.00
Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla				3,280.00	500.00	2,780.00

Shënimi 7 : Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		
Komisionarët					99,735.00
Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime					99,735.00

Shënimi 8: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto	569,698.24	554,356.81	15,341.43
Kontributet pensionale të punëmarrësit	30,399.40	25,300.26	5,099.14
Kontributet pensionale të punëdhënësit	30,399.40	25,300.26	5,099.14
Tatimet në të ardhura personale	33,636.63	27,748.14	5,888.49
Beneficionet tjera	200.00	200.00	0.00
Gjithsej	664,333.67	632,905.47	31,428.20
Shpenzimet e transportit			

Partia Demokratike e Kosovës

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor, 2014

Automjetet motorike të huazuara	0.00	0.00	0.00
Karburantet	35,330.65	31,019.09	4,311.56
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	315.00	315.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	26,144.48	5,384.27	20,760.21
Çdo shpenzim tjetër i transportit	1,822.60	1,822.60	0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	63,612.73	38,540.96	25,071.77
Shpenzimet e kulturës dhe sportit			
Lokali	0.00	0.00	0.00
Ushqimi	86,131.40	30,927.70	55,203.70
Aktivitete kulturore dhe rekreative	21,710.00	21,710.00	0.00
Radio dhe spotet televizive	0.00	0.00	0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta	32,421.61	32,421.61	0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave		0.00	0.00
Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	140,263.01	85,059.31	55,203.70
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës	407,312.02	252,838.54	154,473.48
Gjithsej shpenzimet e fushatës	407,312.02	252,838.54	154,473.48
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	2,787.48	2,191.70	595.78

Partia Demokratike e Kosovës

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor, 2014

Pajisjet të vogla			0.00
Gjithsej blerja e mallrave	2,787.48	2,191.70	595.78
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	46,379.50	43,300.00	3,079.50
Telefoni, interneti dhe posta	15,113.52	15,246.72	(133.20)
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	16,189.39	16,742.46	(553.07)
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	45,777.02	////////////////////	////////////////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime	-	-	-
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	123,459.43	75,289.18	2,393.23
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	9,621.40	9,621.40	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	30,175.94	30,175.94	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	39,797.34	39,797.34	0.00
Gjithsej shpenzimet	1,441,565.68	1,126,622.50	269,166.16

Shënimi 9: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

Qëllimi i pagesës	Pranuar nga			Data kur është bere pagesa	Vlera ne Euro
	Person fizik / juridik	Adresa	Numri Personal		
FURNIZIM	TORA	Prishtinë			27,045.10
KARBURANTE	RACIONAL COMERCE	Prishtinë			77,797.76
QIRA	ZYRET	Prishtinë			27,388.00
Furnizime	TORA	Prishtinë			27,045.10
PARAPAGIM I LAJM.	KOSOVA PRESS	Prishtinë			30,600.00
RRYMA	KEK	Prishtinë			32,269.27
LOGO,DISTINKTIVET	GAN DIZAJN	Prishtinë			13,000.00
SALLA-SHERBIME	EMERALD HOTEL	Prishtinë			19,775.30
REKLAMA-FUSHATE	STUDIO D-LINE	Prishtinë			190,753.05
PAISJE KOMPJUTERIK	COMETRADE COMP.	Prishtinë			17,595.00
Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro :					434,304.93